

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, dhe 193/24, dhe në lidhje me nenin 92 paragrafët 1 dhe 3 nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.-1-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4783/1, datë 19.11.2024 dhe Konkluzioni ark.nr.02-5193/13 datë 26.12.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 46-të mbajtur më 25.12.2024, miratoi si vijon:

### **Aktvendim për ndërmarrje të masës - paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, për shkak të shkeljes së kryer të nenit 92 paragrafët 1 dhe 3 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 4 nëntor 2024, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, as së paku gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, transmetuar në periudhën prej orës 7:00 deri në 19:00.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4783 datë 19.11.2024, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

### **A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të Ligjit në fjalë, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesit të medias (radio transmetuesit) ndërmerr masë - vërejtje publike në rastet kur ka cënim ose shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe aktet nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushtet dhe detyrimet e përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 92 paragrafët 1 dhe 3 të LSHMAAV, Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbime programore televizive janë të detyruara të transmetojnë së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio ose audiovizuale maqedonase, dhe shërbimi publik transmetues së paku 40%. Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbime programore televizive janë të detyruara së paku gjysmën e detyrimeve të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni t'i realizojnë në periudhën prej orës 07:00 deri në ora 19:00.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia përmes Sektorit për Çështje Programore, më 19 nëntor 2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) dhe ka konstatuar se më 4 nëntor 2024 shërbimi programor televiziv i SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase dhe as nuk ka transmetuar së paku gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, transmetuar në periudhën prej orës 7:00 deri në ora 19:00.

Gjegjësisht, nga mbikëqyrja është konstatuar se më 4 nëntor 2024, shërbimi programor televiziv i SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, ka transmetuar 30 minuta dhe 26 sekonda programi të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, që përbën **2.41%** në total të programit të transmetuar gjatë ditës që përfshihet në llogaritjen për programin e krijuar burimor (21 orë e 39 sekonda). Minimumi ligjor prej 30% për transmetim të programit burimor gjatë një dite, në raport me totalin e programit të transmetuar më 4 nëntor që përfshihet në llogaritjen për program të krijuar burimor (21:00:39) është 6 orë 18 minuta dhe 12 sekonda. SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar ka transmetuar për 5 orë 47 minuta e 46 sekonda më pak program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase.

Gjysma e minimumit ligjor (nga ora 06:18:12) është 3 orë 9 minuta dhe 6 sekonda program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, që së paku duhej të transmetohej në programin e Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, në periudhën prej orës 7:00-19:00. Gjatë kësaj periudhe, siç konstatohet nga mbikëqyrja, janë transmetuar 30 minuta dhe 26 sekonda program i krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, që në këtë situatë është 2 orë 38 minuta dhe 40 sekonda më pak se minimumi i kërkuar.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4783/1 datë 19.11.2024, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, me datë 21.11.2024, dërgoi Shkresë ark.nr. 10-4783/2 datë 21.11.2024, me të cilën i dorëzoi dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4783/1 datë 19.11.2024, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 25.11.2024. Në afatin e paraparë SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 25.12.2024, e shqyrtoi lëndën Rraport me shkrim dhe konstatoi që SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 92 paragrafët 1 dhe 3 të Ligjit të njëjtë, pika 6 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4783/1 datë 19.11.2024, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuara në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 46-të mbajtur më 25.12.2024, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-5193/13 datë 26.12.2024, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmërohet SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 paragrafët 1 dhe 2 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

#### **Shtojcë (1):**

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4783/1 datë 19.11.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI. d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.